



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Shëndetësisë / Ministerstvo Zdravstva / Ministry of Health

Në bazë të Ligjit Nr. 08/L – 197 për zyrtarët publikë, Neni 39 (1,2,3,4,5 dhe 6) dhe Rregullores (QRK) NR. 15/2023 për pranimin dhe karrierën në shërbimin civil të Republikës së Kosovë, Neni 5 Ministria e Shëndetësisë shpall:

Konkurs

Pranim

Aplikimi është i hapur për të gjithë kandidatët e interesuar.

Titulli i pozitës së punës	Drejtor i Departamentit për Zhvillim Strategjik
Klasa e pozitës	Drejtues i Mesëm
Koeficienti/Paga	Koeficienti (8.4)
Nr. i kërkuar	1
Kohëzgjatja e emërimit	Me mandat 4 vjeçar
Data e njoftimit	13/05/2024
Afati për aplikim	14/05/2024 - 12/06/2024
Institucioni	Ministria e Shëndetësisë
Departamenti	Departamenti për Zhvillim Strategjik Shëndetësor
Divizioni	
Vendi i punës	Ministria e Shëndetësisë
Nr. i Referencës	RN00014005
Kodi	RPC0007544



1. Përshkrimi i përgjithshëm i punës

1. Mbështet dhe ofron këshilla për udhëheqësin më të lartë administrativ të institucionit dhe/ose titullarin e institucionit pér politikat dhe objektivat e institucionit në fushën e përgjegjësisë së Departamentit;
2. Identifikon nevojat pér zhvillimin e politikave dhe objektivave të institucionit dhe bën rekomandime brenda përgjegjësisë së Departamentit;
3. Drejton dhe mbikëqyrë të gjitha aktivitetet e Departamentit dhe siguron funksionim efikas si dhe harton dhe mbikëqyr politika, standarde dhe kritere pér infrastrukturë në sektorin e shëndetësisë;
4. Është përgjegjës pér përcaktimin e objektivave dhe planifikimin e veprimtarisë së Departamentit dhe zgjidhjen e problemeve profesionale që lidhen me Departamentin;
5. Menaxhon me burimet njerëzore dhe buxhetin e Departamentit, si dhe identifikon nevojat pér ngritjen e kapaciteteve të stafit të Departamentit;
6. Organizon dhe shpërndan punën pér varësit e tij dhe menaxhon realizimin e detyrate dhe përgjegjësive që duhen përmbushur në përputhje me objektivat dhe përgjegjësitë e Departamentit në përputhje me legjislacionin, politikat institucionale dhe standardet përkatëse;
7. Me autorizimin e mbikëqyrësit, përfaqëson institucionin në takime pune, konferanca në fushën e përgjegjësisë në ngjarjet brenda dhe jashtë vendit, pér të elaboruar çështjet që kanë të bëjnë me politikat dhe strategjitë shëndetësore;
8. Bën vlerësimin e rezultateve në punë pér stafin nën mbikëqyrje të drejtpërdrejtë të tij dhe identifikon nevojat pér zhvillimin e kapaciteteve të tyre përmes trajnimeve.
9. Harton deklaratat e politikave shëndetësore në emër të ministrisë, duke adresuar çështjet dhe mungesat aktuale të sektorit shëndetësor ose angazhimin në veprimet e nevojshme pér përmirësimin ose zhvillimin e sektorit shëndetësor;
10. Mbikëqyrë zhvillimin e dokumenteve analitike pér nevojat e vendim marrësve në institucion, duke elaboruar dhe sugjeruar mundësitë strategjike pér zbatimin e politikave, koston dhe përfitimet e këtyre opsjoneve dhe ndikimin e tyre në ekonomi, të drejtat e njeriut ato gjinore, mjedisore dhe të ngashme;
11. Zhvillon strategji afatshkurtra dhe afatmesme pér zhvillimin e burimeve njerëzore në sistemin shëndetësor, dhe ndër të tjera të udhëheqë edukimin shëndetësor pér të ngritë nivelin e njohurive dhe shkathtësive në sistemin e kujdesit shëndetësor;
12. Zhvillimi i planit vjetor të veprimit duke shpërndarë detyrat e departamentit në mes të punëtorëve dhe duke vendosur indikatorët e përformancës pér punëtorët e departamentit;
13. Mbikëqyrë procesin e zbatimit të politikave dhe bënë raporte mbikëqyrëse të duhura;
14. Përgatit raporte të rregullta pér punën e departamentit, dhe kryen edhe punë të tjera sipas kërkësës nga menaxhmenti i lartë.



2.Kriteret e përgjithshme për pranimin në detyrë, sipas nenit 9 të LZP-së

- Të jetë shtetas i Republikës së Kosovës;
- Të ketë zotësi të plotë për veprim, sipas legjisacionit në fuqi;
- Të zotërojë të paktën njëren nga gjuhët zyrtare, në pajtim me Ligjin për Gjuhët;
- Të jetë e/i aftë për të kryer detyrën përkatëse;
- Të mos jetë e/i dënuar për kryerjen e një veprës penale me dashje;
- Të mos ketë në fuqi masë disiplinore për shkelje të rëndë në institucion publik.
- Të ketë arsimin, përvojën e punës profesionale dhe/apo aftësitë e kërkuar për pozitën, kategorinë, klasën apo grupin përkatës.
- Të kaloj me sukses procedurat e pranimit të përcaktuara në këtë ligj.

3. Kërkesat e përgjithshme formale

a) Arsimimi i kërkuar: Diplomë e arsimit të lartë e nivelit të parë (Bachelor) ose në një nga nivelet e arsimimit të lartë (studime bazë Master apo Doktoraturë) në Mjekësi ose Përgjithshme, Mjekësi tjetër ose Menaxhim tjetër Mjekësor.

b) Përvoja e punës e kërkuar: Së paku pesë (5) vite përvojë pune profesionale duke përfshirë njëren nga kërkesat në vjimin:

b.1.) tre (3) vite përvojë pune në pozita drejtuese, ose

b.2.) dy (2) vite përvojë punë në pozita drejtuese dhe diplomë të nivelit të dytë të arsimit të lartë (master), ose

b.3.) një (1) vit përvojë punë në pozita drejtuese dhe diplomë të nivelit të tretë të arsimit të lartë (doktoraturës).

4. Njohuritë, aftësitë dhe cilësitë e kërkuar në procedurën e rekrutimit

- Aftësi të larta organizative, drejtuese dhe për hartim politikash.
- Aftësi për t'iu përshtatur prioriteteve dhe kërkësave, afateve kohore përmes aftësive të nivelit të lartë analistik dhe zgjidhjes së problemeve.
- Njohuri të gjëra lidhur me fushën e përgjegjësisë së Departamentit, menaxhimin e buxhetit dhe të shërbimit civil.
- Aftësi komunikimi dhe bashkëpunimi, përfshirë aftësinë për të krijuar dhe mbajtur marrëdhënie mirëbesimi me eprorin dhe stafin që e menaxhon.
- Aftësi për të motivuar stafin dhe për të menaxhuar me sukses projektet e Departamentit.
- Njohja e gjuhëve të huaj (e preferueshme).



5. Dokumentet që duhet të dorëzohen si pjesë e aplikimit dhe mënyrën e dorëzimit të tyre

- Kopjen e letërnjoftimit/pasaportës/certifikatës së shtetësisë së Republikës së Kosovës.
- Kopjen e diplomës të kërkuar me konkurs të lëshuar nga institucionet arsimore të Republikës së Kosovës. Nëse diploma është fituar jashtë vendit, vërtetimin e nostrifikimit të diplomës së fituar apo aktin që dëshmon se diploma e fituar është në procedurë të nostrifikimit, me kusht që nostrifikimi i diplomës të dorëzohet deri në momentin e nënshkrimit të aktit për emërim në pozitë;
- Kopjet e dëshmisë së punësimit(vërtetim/kontratë) të lëshuar nga institucioni përkatës i punësimit për përvojën e punës, që përcakton pozitën e punës si dhe kohëzgjatjen e angazhimit në atë pozitë.Dëshmisë e punësimit jashtë institucioneve publike duhet të mbështet së paku njëra nga dëshmitë si në vijim: pasqyra e pagesave në fondin e kursimeve pensionale apo pasqyra e pagesave të obligimeve tatimore në përputhje me legjislacionin tatimor për të ardhurat personal.
- Dëshmi që nuk ka në fuqi masë disiplinore për shkelje të rëndë në institucion publik (vlen për të punësuarit në institucion publike).Kandidatët që nuk janë të punësuar në institucion publike duhet të dërgojnë një vetëdeklaratë me shkrim të nënshkruar se nuk kanë masë disiplinore për shkelje të rëndë në institucion publik.
- Dëshmitë e trajnimeve profesionale të ndjekura apo trajnimeve që aplikuesi i ka realizuar në cilësinë e trajnuesit.
- Kopjet e dokumenteve tjera që provojnë plotësimin e kushteve për aplikim të përcaktuara në shpalljen e rekrutimit dhe të deklaruara në aplikacion.

Dëshmitë që nuk kërkohen gjatë aplikimit, por në fazën e verifikimit para emërimit

- Certifikatë mbi dënimet penale origjinale e lëshuar nga gjykata përmes së cilës dëshmohet se nuk është i/e dënuar për kryerjen e veprës penale me dashje, jo më të vjetër se(6) muaj nga data e lëshimit.
- Dëshmi se kandidati është i aftë në pikëpamje shëndetësore.
- Dëshmi përkatëse se kandidati ka zotësi të plotë për të vepruar.

6. Data e daljes së rezultateve të vlerësimit paraprak

- Lista e kandidatëve të cilët plotësojnë kushtet për pranim do të shpallet më së largu deri më datën 27/06/2024, në portalin e rekrutimit elektronik (<https://konkursi.rks-gov.net>)

7.Kriteret specifike shtesë

///

8. Mënyra e vlerësimit të kandidatëve/aplikantëve

- Testimi me shkrim – maksimumi 70 pikë
- Intervista – maksimumi 30 pikë

9. Mënyra e njoftimit dhe komunikimit me kandidatët

- Përmes email dhe portalit për rekrutimi elektronik (<https://konkursi.rks-gov.net>)



10. Mënyra e aplikimit

- Përmes portalit për rekrutimi elektronik (<https://konkursi.rks-gov.net>)

11. Data e shpaljes së rezultateve përfundimtare

- Në përfundim të vlerësimit të kandidatëve, fituesi do të shpallet përmes portalit për rekrutimi elektronik (<https://konkursi.rks-gov.net>). Të gjithë kandidatët pjesëmarrës në këtë procedurë do të njoftohen individualisht në mënyrë elektronike.

Të dhëna shtesë:

- Pas përzgjedhjes së kandidatit fitues, njësia përgjegjëse bën verifikimin para emërimit me qëllim të vërtetimit se kandidatët vazhdojnë të plotësojnë kriteret e konkursit, përmes dokumenteve ne origjinal apo të njësuara me origjinalin.

Komunititet jo shumicë dhe pjesëtarët e tyre, personat me aftësi të kufizuar dhe gjinia më pak e përfaqësuar kanë të drejtë për përfaqësim të drejtë dhe proporcional në shërbimin civil të Kosovës, siç specifikohet në LZP. Aplikacionet e dorëzuara pas afatit të paraparë nuk pranohen dhe aplikacionet e mangëta refuzohen

